



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 8 datë 31.1.2024**

**“PËR NJË SHITESË PLANI DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË  
SHKODËR PËR “PROJEKTIN HOLD ON - NXITJA E AKSESIT NË  
MBËSHTETJEN E SHËNDETIT MENDOR PËR TË RINJTË”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 31.1.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar ; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar ; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, udhëzimit nr.35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar; Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara e datës 04.12.2017. Marrëveshja e programit Erasmus+ 2021-2027 e miratuar ndërmjet Agjencisë Kombëtare dhe Bashkisë Shkodër, ku Bashkia Shkodër ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë” me nr.20713 Prot, datë 29.12.2023; VKB Nr. 55, Datë 29.12.2023 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë.

**V E N D O S I**

1. Të miratojë shtesën e planit dhe ndryshimin në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin “HOLD ON - Nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë”, financuar në kuadër të programit “Erasmus+”, i financuar nga Agjencia

Kombëtare Franceze për të mbështetur projekte në fushën e rinisë dhe sportive, në programin Erasmus+ 2021-2027, në shumën 27562.00 EURO, e konvertuar në 2,869,000 LEK.

2. Kontributi i Bashkisë Shkodër do të jetë mbulimi i vlerës së TVSH 20% me vlerë 435,000 Lek. Ky kontribut do të merret nga tepricat e programit 10430 "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët" të vitit 2023.
3. Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 "Kujdesi social për familjet dhe fëmijët" sipas tabelës së mëposhtme dhe fishës bashkëlidhur.

<b>Shpenzimet e llogaritura</b>				
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet</b>	<b>Totali</b>	<b>Nga kjo:</b>		
	<b>(Lek)</b>	<b>Paga</b>	<b>Sigurime shoq + shënd</b>	<b>Shpenzi me Operative</b>
<b>Shuma 2024</b>	<b>2,816,000</b>	550,000	92,000	2,174,000
<b>Shuma 2025</b>	<b>53,000</b>	45,000	8,000	
<b>Shuma totale e Projektit e financuar nga Projekti</b>	<b>2,869,000</b>	595,000	100,000	2,174,000
<b>Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër</b>	<b>435,000</b>			435,000
<b>Totali</b>	<b>3,304,000</b>	<b>595,000</b>	<b>100,000</b>	<b>2,609,000</b>

4. Miratimin e shtesës së numrit të punonjësve dhe miratimin e nivelit të pagës për punonjësit e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2024 dhe 2025.

Projekti ka parashikuar të punësojë një punonjës në rolin specialist - Koordinator Projekti sipas angazhimit: 12 muaj në vitin 2024 dhe 1 muaj në vitin 2025.

Fondi i përllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori.

Niveli i pagës do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

<b>Emërtimi</b>	<b>Punonjës</b>	<b>I zgjedhur, I emëruar</b>	<b>Arsimi i lartë</b>		<b>Arsimi i mesëm</b>	
			<b>Kategoria</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Klasa</b>	<b>Paga Bazë Mujore</b>
Specialist	1		IV-a	56,000		
<b>Numri i Punonjësve</b>	<b>1</b>					

**Punonjësi do punojë me kohë të pjesshme me 60% të kohës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.**

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

  
**Oltion LULI**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
**Denis Lesha**

Miratuar me 37 vota  
Vota Pro 37  
Vota Kunder 0  
Vota Abstenim 0  
Zbardhur me datë 2.2.2024